

Konsultimet Nacionale me shoqatat e viktimave për draftin e Statutit të KOMRA-së

Tuzëll, BeH,
29. maj 2010.

Konsultimet nacionale me shoqatat e viktimave mbi draft Statutin për KOMRA i ka organizuar Shoqata e gazetarëve të BH-së. Në këtë takim morrën pjesë 28 pjesëmarrës të shoqatave nga BdheH. Moderatore e takimit ishte Dženana Karup Druško, nënkryetare e Shoqatës së gazetarëve të BH-së dhe anëtare e Këshillit Koordinues të Koalicionit për KOMRA. Ligjërues ishin Amir Kulagić (Këshilli Koordinues i Koalicionit për KOMRA), Anđelko Kvesić (Këshilli Koordinues i Koalicionit për KOMRA) dhe Dejan Kožul (koordinator rajonal i procesit konsultativ për KOMRA).

Komentet e pjesëmarrësve/eve në draftimin e Statutit të KOMRA-së:

Neni 5.

Periudha e veprimit

1. Mandati i zgjatjes së KOMRA-s përfshin periudhën dyvjeçare, pas periudhës gjashtëmujore të përgatitjes.
2. KOMRA mund të zgjat mandatin më së shumti gjashtë muaj.

Komentet:

Mandati prej dy vitesh është shumë i shkurtë për tu mbledhur të gjitha faktet.

Ajo që unë mendoj që është periudhë e shkurtë e mbledhjes së të gjitha fakteve për kryerjen e krimeve të luftës dhe shkeljeve tjetra të rënda të të drejtave të njeriut. Mendoj se ai mandate prej dy vite e gjysmë është tejet i shkurtë për tu mbledhur të gjitha faktet. (Mevludin Lupiq, Shoqata e familjeve të burgosurve

dhe personave të zhdukur nga Komuna e Zvornikut, Zvornik, BeH, Konsultimet nacionale me shoqatat e viktimave lidhur me draftin e statutit të KOMRA-së, Tuzëll, BeH, 29. maj 2010.)

Neni 9.

Qëllimet e KOMRA-s

Qëllimet e KOMRA-s janë:

- a) përcaktimi i fakteve të luftërave/konflikteve të armatosura dhe krimeve të luftës dhe shkeljeve tjera të rënda të të drejtave të njeriut në hapësirat e ish RSFJ-së gjatë periudhës 1 janar vitit 1991 deri me 31 dhjetor vitit 2001.

Neni 21.

Kompetencat kohore dhe territoriale të KOMRA-s

KOMRA merret me vërtetimin e fakteve që kanë të bëjnë me krimet e luftës dhe shkeljet e rënda të të drejtave të njeriut, gjatë periudhës nga 1 janari i vitit 1991 deri në 31 dhjetor të vitit 2001, në shtetet e krijuara nga ish- Republika Socialiste Federative e Jugosllavisë (RSFJ), si dhe rrethanave politike dhe sociale gjatë periudhës 1 janar 1980 - 31 dhjetor 2001, të cilat kanë ndikuar në shpërthimin e luftërave/konflikteve të armatosura, kryerjes së krimeve të luftës dhe shkeljeve të rënda të të drejtave të njeriut.

Komentet:

Për shkak të gjeneratave të ardhshme është e rëndësishme të hulumtohet shkakut e jo vetëm pasojat.

Në kontekstin e kësaj që u fol, shumë më pëlqen që të fillohet nga vitet e 80-ta. Të mos fillohet nga pasojat, e të kalohet shkakut. Kjo është shumë e rëndësishme për gjenerata të ardhshme. (Jasmin Imamović, Kryetar i Komunitetit të Tuzllës, BeH, Konsultimet nacionale me shoqatat e viktimave lidhur me draftin e statutit të KOMRA-së, Tuzëll, BeH, 29. maj 2010.)

Thelbi i nacionalizmit fillon nga viti 1941, dhe ky është viti prej kur duhet të hulumtohen shkaqet.

Unë nuk pajtohem, e këtë e kam thënë edhe në disa diskutime të mëhershme gjatë punës së KOMRA-së, se nuk mund të fillojmë me vitet e 80-ta. Vitet e tetëdhjeta e deri te vitet e nëntëdhjeta, kanë qenë vitet kur populli ka jetuar mirë, por vetëm populli, ndërsa në të tri bashkësitë etnike janë formuar foletë nacionaliste, dhe ato fole të nacionalizmit kanë filluar nga viti '41. Kujtojeni vitin shtatëdhjetë e një, që ka ndodhë e njëjta gjë në Bosne. Çka ka mund të ndodhë? A e dini apo ta theksoj, një grup të future, i cili atëherë ta tentuar ta shkatërrojë rendin shtetërorë të Republikës Socialiste të Jugosllavisë. Dhe ato janë ato foletë e tri bashkësive nacionaliste, të cilat me çdo kusht kanë dashtë ta shkatërrojnë atë Jugosllavi. (Dragislav Mijanoviq, Shoqata e invalidëve ushtarak, Zvornik, BeH, Konsultimet nacionale me shoqatat e vitkimave lidhur me draftin e statutit të KOMRA-së, Tuzëll, BeH, 29. maj 2010.)

Edhe sot shkelen të drejtat e njeriut me fshehjen e varrezave masive.

Unë kam thënë se afati kohor dhe kompetenca territoriale e KOMRA-së, këtu është e cekur saktë sipas datave koha prej kur dhe deri kur është juridiksioni territorial, dhe do ta them se pajtohem me datën e fillimit, ajo është 1 janar '80, por nuk pajtohem me datën 31 dhjetor 2001, sepse duke marrë parasysh faktin se në Bosnë e Hercegovinë akoma kërkohen rreth 10.000 persona të zhdukur, ne sot e kemi situatën që sot në Bosnë e Hercegovinë dikush po i shkel të drejtat e njeriut duke i fshehë varrezat masive, dhe mendoj se megjithatë kompetenca e këtij komisioni duhet të jetë që në afat kohor sa më të shkurtë të vijmë deri të njohuritë dhe informatat se ku gjenden ato varreza masive. Prandaj, mendoj se kjo datë, ky është mendimi i organizatës së cilës i takoj, që 31 dhjetor 2001, të jetë afati i fundit kohor kur do të kryhet dokumentimi i fakteve. (Mevludin Lupiq, Shoqata e familjeve të burgosurve dhe personave të zhdukur nga Komuna e Zvornikut, Zvornik, BeH, Konsultimet nacionale me shoqatat e vitkimave lidhur me draftin e statutit të KOMRA-së, Tuzëll, BeH, 29. maj 2010.)

Të zgjatet periudha që do ta përfshijë KOMRA.

Sa u përket këtyre pengesave dhe përfundimit të kohëzgjatjes së KOMRA-së, deri kur është ajo periudhë, unë pajtohem me kolegët që thonë se nuk duhet të kufizohemi në atë periudhë, sepse në sigurisht kemi shkelje të rënda të të drejtave të viktimave dhe anëtarëve të familjeve të tyre, nga secili individ apo institucion i/e cili në çfarëdo mënyrë bënë pengese në gjetjen, identifikimin e viktimave dhe në ndëshkimin e kryesve të veprave. (Goran Drazhiq, Shoqata – së bashku deri te e vërteta, Banja Llukë, BeH, Konsultimet nacionale me shoqatat e viktimave lidhur me draftin e statutit të KOMRA-së, Tuzëll, BeH, 29. maj 2010.)

Kufizimi në vitet 1980, vendos gurë themelin për konflikte të reja.

Kufizimi i KOMRA-së në vitet e tetëdhjeta e deri tani, shkakton parakusht apo vënien e gur-themelit për konflikte të reja. (Mirko Shimunoviq, Shoqata e familjeve të të vrarëve dhe të zhdukurve, Zhepë, BeH, Konsultimet nacionale me shoqatat e viktimave lidhur me draftin e statutit të KOMRA-së, Tuzëll, BeH, 29. maj 2010.)

Neni 10.

Përbërja e KOMRA-së

[Opsioni A– rekomandim i Grupit punues]

KOMRA përbehet nga 20 anëtar apo anëtare siç janë:

- a. Bosnja dhe Hercegovina zgjedh pesë anëtarë apo anëtare;
- b. Kroacia, Kosova, Serbia zgjedhin nga tre anëtarë apo anëtare;
- c. Mali Zi, Maqedonia dhe Sllovenia zgjedhin nga dy anëtarë/anëtare.

Komentet:

Duhet të bëhet rishikimi dhe definimi i viktimave.

Mendoj se nga Bosnë e Hercegovina duhet të jenë pesë anëtarë ose më shumë, për shkak të shumë arsyeve. Mendoj se këtë nuk kam nevojë ta sqaroj, sepse nëse do të jenë tre anëtarë atëherë do të, natyrisht nënkuptohet se do të jenë një boshnjak, ndërsa nga Serbia do të jenë katër, nga Kroacia katër, etj, të mos e argumentoj. Kur është fjala për regjistrimin e viktimave në njerëz, mendoj se këtu duhet bërë ndryshim. Do ta paraqes vetëm një shembull. Shumë viktimë nga rajoni prej nga vi unë, të cilat janë vrarë si civil gjatë kohës së drekës, gjatë kohës kur kërkonin ujë dhe ushqim, etj, janë shënuar si luftëtarë, në fakt ata janë vrarë si civil, e të mos vazhdoj më tutje, ky ishte një shembull. (Fikret Grabovica, Shoqata e prindërve të fëmijëve të vrarë në Sarajevën e rrethuar gjatë viteve '92-'95, Sarajevë, BeH, Konsultimet nacionale me shoqatat e viktimave lidhur me draftin e statutit të KOMRA-së, Tuzëll, BeH, 29. maj 2010.)

Pakicat e lëna anash.

Unë do ta përmendi nenin 10, ku Bosna e Hercegovina i zgjedhë pesë anëtarë apo anëtare. Kjo është pak, nëse e kemi parasysh se në Bosnë e Hercegovinë janë tri bashkësi nacionale, andaj le të jenë nga dy anëtarë nga secila bashkësi nacionale, e kjo i bie të jenë gjashtë, e ku janë pakicat. Pra, 6+1, i shtati të jetë nga pakicat nga Bosnë e Hercegovina. (Dragislav Mijanoviq, Shoqat e invalidëve ushtarak të luftës, Zvornik, BeH, Konsultimet nacionale me shoqatat e viktimave lidhur me draftin e statutit të KOMRA-së, Tuzëll, BeH, 29. maj 2010.)

Marrja e vendimeve e paqartë nëse KOMRA do ti ketë 20 anëtarë.

Në njërën nga nenet e draftit të Statutit janë propozuar dy versione, që komisioni rajonal tiketë 20 apo 21 anëtarë. Unë e përkrahi opsionin A, jo për shkak të numrit të anëtarëve, por për arsye të një llogarie matematikore. Megjithatë, pajtohem me të gjithë ata, se e kemi një situatë jo logjike, të cilët thonë se disa vendime të cilat merren në kuadër të KOMRA-së të respektohet parimi I dy të tretave. Dy të tretat e njëzet e njëshit nuk është numër i rrumbullakuar, kështu që është e paqartë. (Amir Kulagiq, Këshilli koordinues i Koalicionit për KOMRA-në, BeH,

Konsultimet nacionale me shoqatat e viktimave lidhur me draftin e statutit të KOMRA-së, Tuzëll, BeH, 29. maj 2010.)

Të rritet numri i anëtarëve nga BeH, dhe ate nga radhët e minoriteteve (pakicave)

Pajtohem me zotërinë nga Zvorniku se nga Bosna e Hercegovina përpos anëtarëve të komisionit nga radhët e boshnjakëve, kroatëve dhe serbëve duhet të ketë përfaqësues edhe nga radhët e të tjerëve, sepse është treguar, gjatë këtij procesi konsultativ, se shumë prestarë të pakicave të caktuara kanë pësuar, andaj duhet tua ofrojmë shansin që edhe ata duke punuar përmes komisionit rajonal të tregojnë për vuajtjet e tyre dhe të marrin pjesë në evidentimin e këtyre vuajtjeve. Çështja tjetër, mendoj se pesë anëtarë nga Bosna e Hercegovina janë pak, dhe se propozimi për shtatë anëtarë është shumë më korrekt. (Amir Kulagiq, Këshilli koordinues i Koalicionit për KOMRA-në, BeH, Konsultimet nacionale me shoqatat e viktimave lidhur me draftin e statutit të KOMRA-së, Tuzëll, BeH, 29. maj 2010.)

Neni 22.

Veprat që janë në kompetencë të KOMRA-s

KOMRA hulumton këto forma të shkeljes së të drejtave të njeriut, por nuk kufizohet vetëm në to:

- a. vrasja e civilëve dhe robërve të luftës;
- b. robërimi;
- c. burgimi i paligjshëm;
- d. deportimi dhe zhvendosjet e dhunshme të popullsisë;
- e. dhunimi dhe format tjera të rënda të keqtrajtimit seksual;
- f. torturimi dhe format tjera të trajtimit çnjerëzor, përmes të cilave qëllimisht shkaktohen vuajtje të mëdha;
- g. zhdukjet e dhunshme;
- h. marrja dhe shkatërrimi i pronës në përmasa të mëdha;
- i. marrja e pengjeve;
- j. shkatërrimi i objekteve fetare dhe kulturore-historike;
- k. shfrytëzimi i civilëve dhe të robërve të luftës si “mure të gjalla”.

Komentet:

Mungon gjenocidi.

Në nenin 22 janë listuar një sërë shkeljesh të të drejtave të njeriut dhe të krimeve të luftës. Mungon diçka që do të duhej të ishte, dhe këtë e them nga përvoja personale si dhe nga këndvështrimi personal pa kurrfarë dëshire që të hyj në polemikë me askënd prej jush, në kategorizimin e krimeve mungon krimi i gjenocidit. A do ta kualifikoj atë dikush si krim masiv, etj, meqenëse unë vi nga Srebrenica dhe pasi që Gjykata Ndërkombëtare në Hagë e ka dhënë këtë kualifikim ligjor, mendoj se është jo korrekte të mos jetë në listën e krimeve me të cilat do të merret KOMRA. (Amir Kulagiq, Këshilli koordinues i Koalicionit për KOMRA-në, BeH, Konsultimet nacionale me shoqatat e viktimave lidhur me draftin e statutit të KOMRA-së, Tuzëll, BeH, 29. maj 2010.)

Neni 36.

Roli i KOMRA-s në procedimin penal

KOMRA është e autorizuar si më poshtë:

1. në rast se personi, për të cilin KOMRA ka indikacione se ka kryer krime lufte apo shkelje të rënda të të drejtave të njeriut, i ofron KOMRA-s të dhëna të rëndësishme për zbulimin e vendndodhjes së mbetjeve të personave të zhdukur apo informata për identifikimin e kryesve tjerë, atëherë KOMRA do të propozojë që, në rast procedimi, kjo të merret si rrethanë lehtësuese e rëndësishme gjatë përcaktimit të lartësisë së dënimit nga ana e gjykatës kompetente;
2. të propozojë amnisti të pjesshme për kryesin e veprës penale për të cilën ai është dënuar, nëse një gjë e tillë nuk është në kundërshtim me dispozitat ligjore të shtetit përkatës, në shkëmbim të dhënies së informatave të rëndësishme për zbulimin e lokacioneve me mbetjet e personave të zhdukur apo për gjetjen e kryesve të tjerë;
3. të propozojë zbutjen e dënimit, nëse personi i ofron KOMRA-s të dhëna të rëndësishme për zbulimin e vendit ku janë varrosur mbetjet e personave të zhdukur apo jep informata për zbulimin e kryesve tjerë.

Komentet:

Nëse i akuzuari nuk i ka zbuluar varrezat masive gjatë gjykimit, atëherë ekziston rreziku i keqpërdorimit të zvogëlimit të jashtëzakonshëm të dënimit.

Nëse i akuzuari për kryerjen e krimeve apo urdhër-dhënësi është gjykuar, dhe është duke e vuajtur dënimin, ai e ka pasur rastin më herët ta thotë në Gjykatë, nëse ka dashtë ta thotë atë, e që natyrisht do ti merrej si rrethanë lehtësuese. Unë nuk e shoh se si një kryes i veprës, një i akuzuar, më falni, dikush që është gjykuar për kryerjen e veprës penale të krimit të luftës, tani pas disa vitesh të vuajtjes së dënimit, që do të pranojë t'ia thotë komisionit, jo të pranojë por kam frikë nga keqpërdorimi, sepse ai tashmë është duke e vuajtur dënimin, ndërsa e ka pasur rastin në Gjykatë në mbrojtje të vetë të tregojë kush janë kryesit tjerë dhe ku gjenden lokacionet, dhe vlerësoj se kjo do tu merrej në shqyrtim si rrethanë lehtësuese, të paktën kështu do ta merrnin gjykatat apo prokuroritë. Nëse dikush do të kishte dashtë të tregoj këtë, e ka pasur rastin në gjykatë, ose të jetë dëshmitarë bashkëpunues, apo sido çoftë, e ka pasur rastin. Nuk di, kam frikë nga keqpërdorimi, sepse Komisioni të propozojë zbutje (zvogëlim) të jashtëzakonshëm të dënimit të dikujt që është duke e vuajtur dënimin për diçka që ka bërë.

(Mevludin Lupiq, Shoqata e familjeve të të burgosurve dhe të zhdukurve nga Komuna Zvornik, Zvornik, BeH, Konsultimet nacionale me shoqatat e viktimave lidhur me draftin e statutit të KOMRA-së, Tuzëll, BeH, 29. maj 2010.)

Nevojitet ndihma psikologjike që të mund të flasin viktimat.

Pasi që vi nga "Medika" ndiej nevojën të them se jam e gëzuar, në fakt më vjen shumë mirë, është vështirë të thuhet se jam e lumtur, që viktimave dhe dëshmitarëve t'u ofrohet ndihma psikologjike dhe këshillat si mbrojtje për viktimat dhe dëshmitarët. Do të filloj me atë, se njerëzit kanë nevojë të flasin, vlerësoj se kjo është ndihmë shumë e mirë, dhe se duhet patë kujdes mu për këtë. Nëse kanë kaluar një proces terapie, atëherë edhe terapeuti apo terapeutja janë dëshmitarë të pasojave dhe të asaj çka kanë përjetuar ata. Pra, edhe ata mund të tregojnë se sa të thella dhe të rënda janë plagët dhe lëndimet e tyre. (Nasiha Shehiq, Medika,

Zenicë, BeH, Konsultimet nacionale me shoqatat e viktimave lidhur me draftin e statutit të KOMRA-së, Tuzëll, BeH, 29. maj 2010.)

Secila viktimë duhet të personalizohet.

Që nga fillimi angazhohem që secila viktimë të personalizohet (evidentohet), kjo do të thotë të ketë kartonin e vet në të cilin ne do ta personalizojmë (evidentojmë) atë në kuptimin e emrit, mbiemrit, emrit të babait, numrit amzë, datës së lindjes, vendit të lindjes, pastaj me çka është marrë ai person në të kaluarën, a është i/e martuar, a ka familje – dy segmente shumë të rëndësishme. Pastaj, a ka qenë prestarë i ndonjë formacioni të armatosur apo ka qenë civil, dhe çështja tjetër e rëndësishme është rrethanat nën të cilat ai person ka humbë jetën. Në këtë mënyrë ne e bëjmë dallimin mes atyre që kanë humbë jetën në luftimet e drejtpërdrejta dhe ata të cilët, nëse mund të them, që e kanë humbë jetën në ndonjë mënyrë tjetër, dhe natyrisht në pjesën përfundimtare do të ishte shumë e rëndësishme të dihet a është gjetur ai person, a është identifikuar, a është varrosur. (Amir Kulagiq, Këshilli koordinues i Koalicionit për KOMRA-në, BeH, Konsultimet nacionale me shoqatat e viktimave lidhur me draftin e statutit të KOMRA-së, Tuzëll, BeH, 29. maj 2010.)